



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.164/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa, dega në Gjakovë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Alternativa, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3.500,00 (tremijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 10.10.2017, me të cilën pretendon se kandidatja për Kryetare të Komunës së Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Alternativa, Mimoza Kusari-Lila, në spotin e saj të postuar në rrjetin social Facebook me datë 09.10.2017, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes duke bërë fushatë në objekt publik, konkretisht në ambientet e klubit basketbollistik Vllaznimi, duke shkelur Nenin 35.1 të LZP. Për më tepër kandidatja në video shihet se ka shkelur edhe Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, Neni 5.2 duke përfshirë persona të mitur në fushatë. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Alternativa, të datës 11.10.2017, theksoi se kandidatja për Kuvendin Komunal të Gjakovës, Mimoza-Kusari-Lila ka vajtur për vizitë tek përfaqësuesit e klubit basketbollistik Vllaznimi, me ç'rast ka rezultuar që të jenë prezent pjesëtarë të grup-moshave të ndryshme të cilët janë pjesë e klubit. Po ashtu sa i përket pretendimit ankimorë për shfrytëzim të objektit publikë, kanë shtuar se nuk është bërë shkelje të nenit 35.1 të LZP-së sepse sipas tyre ky nen përcakton "Veprimet e ndaluara për shërbyes publik" dhe në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shërbyes publik por me një subjekt politik, dhe se kjo rregull vlen për 'tubime publike' dhe jo për 'vizita' siç është realizuar këtu nga subjekti politik Alternativa. Edhe përkundër kësaj ky subjekt njofton se video e realizuar nga vizita me klubin e basketbollistëve "Vllaznimi" është larguar nga rrjeti social facebook.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një deklaratë ku shihet konfirmimi i trajnerëve dhe prindërve për pjesëmarrjen e lojtarëve të mitur në video-incizim.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD e ofruar si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Mimoza Kusari-Lila, kandidate për Kryetare të Komunës së Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Alternativa, ka bërë fushatë në objekt publik dhe po ashtu ka përdorur fëmijë në spotin e saj, në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së, e cila përcakton: *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë i nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose e kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”* dhe po ashtu është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: *“Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”*.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Alternativa, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar me arsyetimin se në spotin e inçizuar nga subjekti i tyre nuk kanë bërë shkelje ligjore me vizitën e tyre në objektin publik, gjë e cila nuk qëndron pasi që dispozita ligjore e nenit 35.1 e LZP-së përcakton se *personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje*, ndërsa përgjigja se përfshirëja e fëmijëve ka qenë me pëlqimin e prindërve, pretendimet e tilla nga ana e Panelit janë të paqëndrueshme pasi që dispozita ligjore e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së përcakton qartë se personat të cilat nuk i kanë mbushur moshën 18 vjet nuk mund të përfshihen në fushatën zgjedhore të asnjë subjekti politik të certifikuar për zgjedhje, dhe edhe pse thuhet se kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, nuk kanë ofruar dëshmi për ta vërtetuar atë, i cili veprim ka ndikuar

në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikojë që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen. Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 164/2017 më datën 12.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.

